

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5483  
E mërkurë, 23 maj 2018  
çmimi 0.40 €

## Haradinaj kërkon njohje nga Vatikani



Kryeministri Ramush Haradinaj po qëndron për vizitë zyrtare në Vatikan. Ai të martën është pritur në takim nga sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin ■ FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE



**THAÇI: ËSHTË KOHA PËR ANËTARËSIMIN E TËRË BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE** F. 3



**PËRKUJTOHET MASAKRA E DUBRAVËS** F. 11

**PËRURORHET RRUGA QË LIDH KOSOVËN DHE SHQIPËRINË** F. 8

### EKONOMI

**KONKURRENCA JOLOJALE, BARRIERË E TË BËRIT BIZNES** F. 9

**TAHIRI: FUQIZIMI I SUNDIMIT TË LIGJIT, PARAKUSHT PËR ZHVILLIMIN E BIZNESEVE** F. 8

### SPORT

**HASHANI ZYRTARIZON PENSIONIMIN, PRITET EDHE DRAGUSHA** F. 13

**VUSHTRRIA - FLAMURTARI 'LUFTOJNË' PËR SUPERLIGË** F. 13



FLET PËR "EPOKËN E RE" ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME, IZMI ZEKA ■ FAQE 4-5

## Ka mobilizim për anëtarësimin e Kosovës në Interpol

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka theksuar se anëtarësimi i Kosovës në Interpol mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë. Ai ka thënë se nëpërmjet lobimit Kosova tashmë është pjesë e agjendës për votim në sesionin e ardhshëm të Asamblesë

së Interpolit që do të mbahet në fund të këtij viti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Zeka ka bërë me dije se ka mobilizim të gjerë, në veçanti të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe asaj të Punëve të Brendshme, për koordinim të procesit dhe hartimit të

strategjive të lobimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Në këtë intervistë Zeka ka folur edhe për situatën e sigurisë në vend, për të cilën thotë se është e qetë. Ai ka pohuar se Kosova ka arritur progres në luftën e kërcënimeve që rrjedhin nga terrorizmi

## PAN-i vonon emërimin e anëtarëve të ri të KQZ-së

Tri partitë në pushtet ende nuk i kanë dërguar nominimet e tyre te presidenti për anëtarë të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ani pse anëtarëve aktualë u ka kaluar mandati. Gazeta "Epoka e re", nga burimet bren-

da koalicionit PAN, ka marrë vesh se vonesat në këtë drejtim janë bërë për shkak të mospajtimeve në mes të AAK-së dhe Nismës. Sipas këtyre burimeve, PDK-në në KQZ do ta përfaqësojë Ilir Gashi, ndërkaq Aleancën dhe Nismën

Binak Vishaj. Ndërkaq partitë opozitare i kanë dorëzuar nominimet e tyre. LDK-ja do të përfaqësohet nga Sami Hamiti e Florian Dushi, kurse Vetëvendosja nga Adnan Rustemi dhe Nazlie Bala ■ FAQE 3



## Kompania ajrore që barti turqit e deportuar gënjeu autoritetet e Kosovës

Drejtori i Aviacionit Civil të Kosovës, Driton Gjonbalaj, ka thënë se kompania ajrore me të cilën u deportuan gjashtë shtetasit turq kishte

gënjyer institucionet e Kosovës për qëllimin e fluturimit, pasi leja ishte kërkuar për fluturim komercial

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Hahni: Nuk ka 'ulje të çmimeve', duhen përmbushur pritshmëritë

PARIS, 22 MAJ - Në një intervistë për "Talking Europe", në televizionin francez "France 24", eurokomisionari për zgjerimin, Johannes Hahn, theksoi edhe një herë rëndësinë e integritetit të Ballkanit Perëndimor. Nuk flasim për ulje çmimi, tha ai, por këto vende duhen nxitur e asistuar, pasi "një drekë

nuk jepet falas, ata duhet t'i përmbushin pritshmëritë". "E para, kemi publikuar strategjinë tonë në shkurt, duke i treguar çdo vendi perspektivën, për të gjithë procesin, dhe jo vetëm negociatat, është e bazuar në meritë. Nuk bëhet fjalë për ndonjë ulje çmimi, por është në interesin tonë t'i nxisim e

ndihmojmë, asistojmë. Por, nuk është një drekë falas. Ata duhet t'i përmbushin pritshmëritë", është shprehur Hahni. Ai tha se sot vendet e Ballkanit Perëndimor rrethohen nga vendet anëtare të BE-së dhe nëse një ditë do të bëhen dhe ato anëtare, do të ishte një farë konsolidimi.



## Haradinaj kërkon njohje nga Vatikani

Kryeministri Ramush Haradinaj po qëndron për vizitë zyrtare në Vatikan. Ai të martën është prituri në takim nga Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin. Kryeministri ka kërkuar nga Selia e Shenjtë ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe të krijojë marrëdhënie diplomatike me shtetin më të ri në Evropë

### "Epoka e re"

VATIKAN, 22 MAJ - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, po qëndron për vizitë zyrtare në Vatikan, ku të martën është prituri në takim nga Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin.

Të arriturat e vendit në aspektin politik dhe demokratik, pozicioni i Kosovës karshi vendeve të rajonit dhe bashkëpunimi ekonomik dhe diplomatik me këto vende, ishin disa nga temat e diskutimit në këtë takim. "Kosova është e përkushtuar që ta vazhdojë avancimin e raporteve me Vatikanin dhe se njohja e shtetësisë së Kosovës nga Vatikani është hap i nevojshëm", ka thënë kryeministri Haradinaj. Kryeministri Haradinaj përmendi edhe faktin se liria fetare dhe orientimi euroatlantik i Kosovës

janë vlera të pacenueshme, të cilat duhet të promovohen edhe në raportet mes dy vendeve. "Shteti i Kosovës është faktor i rëndësishëm i paqes dhe i stabilitetit si dhe promovues i fqinjësisë së mirë", tha kryeministri Haradinaj, duke shprehur mirënjohjen e popullit të Kosovës dhe Qeverisë për përkrahjen e vazhdueshme të Selisë së Shenjtë dhënë Kosovës. "Kosova është e interesuar që në Ballkan ta shtyjë procesin e paqes permanente dhe pajtimit. Në të njëjtën frymë, Kosova është e interesuar të ketë marrëdhënie strategjike me Vatikanin", ishte qëndrimi i kryeministrit Haradinaj.

Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro Parolin, e inkurajoi popullin e Kosovës për paqe, pajtim dhe prosperitet me vendet fqinje dhe në rrugën e saj drejt integriteteve euroatlantike.



Qëndrimi i kryeministrit Haradinaj në Selinë e Shenjtë po bëhet në kuadër të vizitës zyrtare në këtë vend, në të cilën do të

zhvillohen një sërë takimesh me nivele të larta dhe me interes për vendin. Pas pritjes nga Sekretari i Shtetit të Vatikanit, kardinali Pietro

Parolin, kryeministri Haradinaj vizitoi edhe Bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan, qendra e Selisë së Shenjtë.



## Rama: Meta, presidenti më i mirë që kemi pasur

TIRANË, 22 MAJ - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një intervistë për "Abcnews" është pyetur për marrëdhëniet me presidentin Ilir Meta, për të cilin çuditërisht nuk i ka kursyer

komplimentet. "Ilir Meta nuk ka bërë asnjë gabim deri më sot. Nuk është se kemi shumë komunikim, por ka pak rëndësi. Ajo që unë vlerësoj është pozicioni që ai mban. Nëse nuk do të

ishite Meta, por një person që s'do të kishte bagazh nga e shkuara, do të ishte shumë keq. Është presidenti më i mirë që kemi pasur", është shprehur Rama.

## Kryemadhi: Rama do të rrëzohet, s'ka Zot që e shpëton

TIRANË, 22 MAJ - Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi, u bëri edhe një herë thirrje shqiptarëve, të bashkohen në protestën e opozitës që do të mbahet të shtunën, më 26 maj. Deklarata e Kryemadhit u bë nga selia e LSI-së, pas takimit që ajo zhvilloi me kryetarët e LSI-së në rrethe. "Ditën e shtunë, në orën 11:00,

do ta protestojmë ndaj kësaj Qeverie. U bëj thirrje të gjithë shqiptarëve që mendojnë se kjo Qeveri po varfëron vendin, që të bashkohen në protestën e së shtunës, intelektualëve, të rinjve që besojnë te një Shqipëri e denjë. Opozita nuk e largon Shqipërinë nga Evropa, por Edi Rama nuk do që kjo gjë të ndodhë", tha Kryemadhi. Sipas saj,

LSI-ja tha se nuk do të ketë asnjë kompromis me një qeveri të zhytur në trafik dhe korrupsion, ndërsa theksoi se pas kaq shumë skandalesh asgjë nuk do të mund ta shpëtojë Qeverinë e Ramës, as prokurorët që, sipas saj, i lëpihen për të kaluar vettingun dhe as Zoti vetë. "E shtuna është dita jonë për t'i treguar Edi Ramës, që asgjë nuk e ndal më popullin nga

revolta e tij. Edi Rama nuk është Zot as i drejtësisë dhe as i shqiptarëve. Nëse Rama do të vazhdojë t'i kërcënojë shqiptarët me bandat e drogës, fundi i tij do të jetë i shpejtë dhe i tmerrshëm. U bëj thirrje të gjithë votuesve të LSI-së, të ngrihemi dhe ta rrëzojmë Edi Ramën. Nuk ka as njeri dhe as Zot që mbron Edi Ramën", tha Kryemadhi.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në Forumin e Sigurisë "To be Secure" (2BS) në Budvë në Mal të Zi

# Thaçi: Është koha për anëtarësimin e tërë Ballkanit Perëndimor në BE

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në fjalimin e tij në Forumin e Sigurisë "To be Secure" (2BS) në Budvë, ka thënë se zgjerimi i BE-së nuk duhet të vihet në dyshim. "Mesazhi im kryesor është: tendenca në rritje e popullizmit e ekstremit të djathtë nuk duhet të përdoret si justifikim për vendet anëtare të BE-së që të mos mbajnë hapur perspektivën e BE-së për Ballkanin Perëndimor", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se është koha për anëtarësimin e tërë Ballkanit Perëndimor në BE

zhvilluar dhe për ta përmirësuar jetën e qytetarëve", ka thënë ai. Presidenti Thaçi ka thënë se kjo është një kohë dhe mundësi për udhëheqësit e Evropës që ta marrin përgjegjësinë dhe për të mos ndjekur politikën reaguese për përfitime afatshkurtra. "Pra, të shohim se çfarë është e mirë për Evropën në një afat të gjatë. Është e qartë se përgjigjja është një BE e zgjeruar që përfshin Ballkanin Perëndimor në tërësi", ka thënë presidenti Thaçi.

Sipas tij, BE-ja e mbështetur nga NATO-ja është projekti më i madh i paqes dhe më i suksesshmi deri më sot. "Në Ballkanin Perëndimor është ndryshe. Kujtimet e luftës dhe vuajtjet e popullit tim janë ende të gjalla tek të gjithë në Kosovë. Për ne, BE-ja është shembulli i paqes, i pajtimit, i tejkallimit të së kaluarës dhe rritjes së bashkëpunimit dhe ndërvarësisë në mënyrë graduale", ka thënë Thaçi, duke shtuar se BE-ja nuk është vetëm projekt i paqes, por edhe një strukturë qeverisëse supranacionale që vazhdimisht zgjeron dhe thëllon bashkëpunimin në të gjitha fushat e politikës.

Duke folur për perspektivën euroatlantike të vendeve të

Ballkanit Perëndimor, presidenti Thaçi ka thënë se Mali i Zi shërben si frymëzim për tërë rajonin, duke mos u ndalur kurrë në angazhimin për integritet euroatlantike. "Ne në Kosovë jemi të lumtur që u bëtë pjesë e NATO-s vitin e kaluar. Anëtarësimi i Shqipërisë dhe i Malit të Zi në NATO krijon një garanci më të madhe për stabilitetin, sigurinë dhe demokracinë në rajon", ka thënë ai.

Shefi i shtetit ka pohuar se konstatimi në këtë forum ishte se shtyllat e Bashkimit Evropian po tronditen, së pari nga kriza ekonomike, pastaj nga kriza e migracionit dhe tani nga Brexit. "Është e rëndësishme kur përballemi me një kontekst kaq kundërshtues, të mos e harrojmë atë që po funksionon aktualisht", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë se rritja e populizmit të krahut të djathtë është një tendencë në Evropë për momentin, por nuk është e vetmja. Sipas tij, tendenca të ndryshme dhe shpesh kundërshtuese janë evidente në të njëjtën kohë. "Kishte shumë që parashikuan një efekt domino të

Brexitit, menjëherë pas referendimit, apo valë të fitoreve të popullizmit. Mirëpo, ajo që kemi parë është se BE-ja qëndron e fuqishme dhe forcat proevropiane kanë fituar në shumicën e shteteve të BE-së", ka thënë Thaçi.

Forumit e Sigurisë "To be Secure" (2BS) është ngjarje që ndihmon jo vetëm nxitjen e ideve të reja rreth sigurisë, por nxit edhe të menduarit taktik në përpjekjet për reforma në Evropën Juglindore. Forumi ka për qëllim ndërtimin e lidhjeve më të ngushta midis aktorëve kryesorë dhe partnerëve, për ta bërë rajonin vend më të sigurt dhe për të kontribuar për tejkallimin e sfidave globale në të ardhmen.

## Thaçi takon Gjukanoviçin, flasin për bashkëpunimin ndërshtetëror

Në kuadër të Forumit të Sigurisë "To be Secure", i cili po mbahet në Budvë, presidenti Hashim Thaçi ka takuar presidentin e Malit të Zi, Milo Gjukanoviç. Në profilin e tij në "Facebook", Thaçi ka shkruar se homologun e ka uruar për rizgjedhjen e tij president dhe për përvjetorin e pavarësisë së Malit të Zi. "Me presidentin Gjukanoviç biseduam për krijimin e një agjende të përbashkët të bashkëpunimit bilateral, duke nxitur një shkëmbim më të madh tregtar dhe bashkëpunim në fushën e integritetevë evropiane. Anëtarësimi i Malit të Zi në NATO ka krijuar një mundësi unike për Kosovën, që të lëvizim më shpejt drejt së ardhmes së përbashkët euroatlantike. Pas Samitit të Sofjes, Ballkanin Perëndimor asnjëherë nuk ka qenë më afër jetësimi të aspiratave për anëtarësim në BE", ka shkruar Thaçi.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

**BUDVË, 22 MAJ** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se zgjerimi i Bashkimit Evropian në drejtim të Ballkanit Perëndimor nuk duhet të vihet në dyshim. Në Forumin e Sigurisë "To be Secure" (2BS), në të cilin ka marrë pjesë me ftesë të Këshillit Atlantik dhe Qeverisë së Malit të Zi, presidenti Thaçi ka thënë se është koha për anëtarësimin e këtij rajoni në BE. "Zgjerimi i BE-së nuk duhet të vihet në dyshim. Prandaj, mesazhi im kryesor është tendenca në rritje e popullizmit e ekstremit të djathtë nuk

duhet të përdoret si justifikim për vendet anëtare të BE-së që të mos mbajnë hapur perspektivën e BE-së për Ballkanin Perëndimor", ka thënë Thaçi. Ai ka vlerësuar se eurskeptizimi nuk duhet të shihet si arsye nga vendet e rajonit për mosrespektim.

Në këtë forum presidenti ka theksuar se për pranimin e suksesshëm të Ballkanit Perëndimor në BE rajoni ka nevojë për reforma të thella politike e ekonomike. "Euroskeptizimi i BE-së dhe lodhja me zgjerimin nuk duhet të përdoren nga politikanët në rajonin tonë si një justifikim për të mos u reformuar, për t'u



## Kosova e gatshme për ta vazhduar fazën e fundit të dialogut

**BUDVË, 22 MAJ** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë qëndrimit në Mal të Zi, në kuadër të Forumit të Sigurisë, është takuar me drejtorin për Evropën Qendrore dhe Jugore të ShBA-së, Matthew Palmer, me të cilin ka biseduar për forcimin e paqes në rajon dhe për rrugëtimin euroatlantik të

vendit tonë. "Në Forumin e Sigurisë 'To be Secure' bisedova për forcimin e paqes në rajon dhe për rrugëtimin tonë euroatlantik edhe me drejtorin për Evropën Qendrore dhe Jugore të ShBA-së, Matthew Palmer. Kosova është e gatshme ta vazhdojë fazën e fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja dhe me përkrahje të fuqishme nga ShBA-ja. Përkrahjen e shteteve të Bashkuara të Amerikës do ta kemi edhe në këtë proces, njëjtë qysh e kemi pasur në çdo hap të rëndësishëm për shtetin tonë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re" zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka

# Ka mobilizim për anëtarësimin e

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, ka theksuar se anëtarësimi i Kosovës në Interpol mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë. Ai ka thënë se nëpërmjet lobimit Kosova tashmë është pjesë e agjendës për votim në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së Interpolit që do të mbahet në fund të këtij viti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Zeka ka bërë me dije se ka mobilizim të gjerë, në veçanti të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe asaj të Punëve të Brendshme, për koordinim të procesit dhe hartimit të strategjive të lobimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Në këtë intervistë Zeka ka folur edhe për situatën e sigurisë në vend, për të cilën thotë se është e qetë. Ai ka pohuar se Kosova ka arritur progres në luftën e kërcënimeve që rrjedhin nga terrorizmi



**EPOKA E RE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 22 MAJ** - Situata e sigurisë në vend është e qetë dhe stabile. Kosova ka arritur progres në luftimin e kërcënimeve që rrjedhin nga terrorizmi, kurse anëtarësimi i Kosovës në Interpol mbetet një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kështu ka thënë të martën, në një intervistë për gazetën "Epoka e re", zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka.

Zeka është i bindur se qeveria në të cilën bën pjesë ka treguar rezultate pozitive në qeverisje duke zhbllokuar disa procese jetike dhe të rëndësishme për qytetarët e Kosovës. Ai ka theksuar se kjo Qeveri ka krijuar një frymë të bashkëpunimit me aktorët e opozitës dhe të sferës së gjerë të shoqërisë për temat e mëdha dhe të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës.

Zëvendësministri Zeka ka thënë se Kosova mbetet e përkushtuar për fqinjësi të mirë në rajon.

**"Epoka e re":** Z. Zeka, si partner i koalicionit që është PDK-ja në këtë Qeveri, sa jeni i kënaqur me qeverisjen në vend?

**Zeka:** Koalicioni qeverisës, pjesë e së cilës është edhe Partia Demokratike e Kosovës si parti që ka vënë interesin shtetëror si parim kryesor politik, ka shtuar dinamikën e reformave dhe të qeverisjes, duke zhbllokuar disa procese jetike dhe të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe për shtetin, si avancimi dhe jetësimi i lëvizjes së lirë pa viza në Zonën Shengen si dhe avancimin në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Kemi krijuar një frymë të bashkëpunimit me aktorët e opozitës dhe të sferës

së gjerë të shoqërisë për temat e mëdha dhe të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës, atë të avancimit të Kosovës në sferën ndërkombëtare, përmbylljen e procesit të dialogut me Serbinë që ka si rezultat përfundimtar edhe njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë. Jemi në proces të ndërmarrjes së reformave të rëndësishme sektoriale dhe projekteve të mëdha infrastrukturore për të cilat do të sjellin përfitime të mëdha për Kosovën në aspektin e zhvillimit ekonomik në të ardhmen. Gjithashtu, mbetemi të përkushtuar për fqinjësi të mirë si parim kryesor i bashkëpunimit rajonal.

**"Epoka e re":** Opozita po thotë se kjo është Qeveri e brishtë.

**Zeka:** Roli i opozitës është të kontribuojë në mënyrë konstruktive në zhvillimet në vend dhe t'i korrigjojë gabimet apo mungesën e progresit nga ana e pozitës. Por, kjo nuk po ndodh. Kjo po vërehet në tryezat e organizuar nga partitë e ndryshme, në të cilat opozita kërkesë kryesore ka shkuarjen në zgjedhje, dhe jo diskutimin e temave të rëndësishme për vendin, për të cilat kërkohet konsensus mbarëkombëtar. Besoj se kjo Qeveri ka dëshmuar dinamikë të shtuar të punës dhe ka dhënë rezultate në procese të ndryshme të rëndësishme për vendin.

**"Epoka e re":** Amund të mbijetojë deri në fund të mandatit ky koalicion qeverisës?

**Zeka:** Besoj fuqishëm se ky koalicion do ta çojë mandatin e vet deri në fund dhe do të arrijë rezultate të mëdha në konsolidimin e proceseve të rëndësishme për shtetin e Kosovës si për ndërmarrjen e reformave që kanë për qëllim zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e

jetës së qytetarit të Kosovës, por edhe në avancimin e proceseve në sferën e integritimit evropian dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Ne si PDK besojmë se do të vazhdojmë të mbetemi në pushtet edhe në mandatin e ardhshëm qeverisës.

**"Epoka e re":** Ju si po e ndieni veten si zëvendësministër i Punëve të Brendshme kur kemi parasysh se janë rreth 70 zëvendësministra të tjerë në këtë Qeveri. Dhe në këtë drejtim ka pasur kritika për numër të madh të zëvendësministrave?

**Zeka:** Unë jam emëruar në pozitën e zëvendësministrit të Punëve të Brendshme nga ana e kryeministrit të Republikës së Kosovës. Kjo do të thotë se punoj në një ministri dhe sektor shumë të ndjeshëm dhe të rëndësishëm, për të cilën ka

nevojë për shumë ekspertizë dhe angazhime në vendimmarrje për politikën e Qeverisë për sektorin e sigurisë dhe për përgjegjësitë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Duhet theksuar se, përveç të tjerash, Ministria e Punëve të Brendshme koordinon një numër të konsiderueshëm të strategjive kombëtare me përgjegjësi implementuese ndër-institucionale për çfarë kërkon edhe përcjellje të këtyre strategjive të nivelit politik dhe vendimmarrës. Unë besoj se secili zëvendësministër ka hapësirë dhe punë për të punuar në drejtim të zhvillimit të proceseve që presin Kosovën, sidomos në aspektin integruar dhe atë ekonomik.

**"Epoka e re":** Cili është angazhimi juaj për kryerjen e detyrave si zëvendësministër

në MPB?

**Zeka:** Si zëvendësministër i Punëve të Brendshme jam caktuar koordinator i tri strategjive kombëtare: strategjisë kombëtare për migrim, strategjisë kombëtare për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe strategjisë kombëtare për armët e vogla dhe të lehta. Përveç caktimit në cilësinë e koordinatorit për këto tri strategji duhet theksuar se jam vazhdimisht i angazhuar për përcjelljen e agjendës politike të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ministrit.

**"Epoka e re":** Cila është situata e sigurisë në vend?

**Zeka:** Situata e sigurisë në vend vlerësohet të jetë e qetë dhe nuk ka indikacione të kërcënimeve për sigurinë në vend dhe më gjerë. Ky vlerësim është dhënë edhe nga mekanizmat e

# Kosovës në Interpol



sigurisë në vend dhe nga ato ndërkombëtare. Kemi bërë progres të rëndësishëm në luftimin e kërcënimeve që rrjedhin nga terrorizmi dhe kemi partneritet të shkëlqyer me mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtarë në fushën e sigurisë për t'iu përgjigjur çdo kërcënim që mund t'i kanoset vendit.

"Epoka e re": Po në veri?

Zeka: Situata në veri është e qetë dhe tani kemi arritur ta shtrijmë sovranitetin në këtë pjesë të territorit të Kosovës dhe të ofrojmë qasje në shërbime publike dhe në ato të sigurisë. Gjithashtu, kemi ndërmarrë masa për t'iu luftuar të gjitha format e krimit të organizuar edhe në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

"Epoka e re": Çfarë aktiviteteve është duke bërë MPB-ja për anëtarësim në Interpol?

Zeka: Anëtarësimi i Kosovës në Interpol mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Jeni të njoftuar se së fundi kemi arritur që përmes lobimit të vendosim Kosovën në agjendën për votim në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së Interpolit që do të mbahet në fund të këtij viti. Gjithashtu, kemi një grup punues ndërinstitucional dhe ka mobilizim të gjerë, në veçanti të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, në koordinim të procesit dhe hartimit të strategjive të lobimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol.

"Epoka e re": Paraqitja e problemit me armë të vogla në Kosovë fillet i ka pasur luftës së vitit 1998-99 dhe, si pasojë, ne kemi numër të konsiderueshëm të armëve të cilat kanë mbetur në duart e qytetarëve. Çfarë po bëni në këtë drejtim si MPB?

Zeka: Ne si Ministri e Punëve të Brendshme dhe Qeveri e Kosovës kemi hartuar politika specifike për adresimin e këtij problemi, i cili shfaqet me pasoja, sidomos gjatë festimit të ceremonive të ndryshme gjatë verës. Ne do të vazhdojmë që përmes mekanizmave politikë dhe operacionale t'i bindim qytetarët e Kosovës të mos mbajnë armë të vogla, sidomos në mënyrë joligjore, sepse Kosova i ka mekanizmat që ofrojnë siguri individuale dhe kolektive.

## Kompania ajrore që barti turqit e deportuar gënjeu autoritetet e Kosovës

Drejtori i Aviacionit Civil të Kosovës, Driton Gjonbalaj, ka thënë se kompania ajrore me të cilën u deportuan gjashtë shtetasit turq kishte gënjyer institucionet e Kosovës për qëllimin e fluturimit, pasi leja ishte kërkuar për fluturim komercial

PRISHTINË, 22 MAJ - Drejtori i Aviacionit Civil të Kosovës, Driton Gjonbalaj, ka bërë me dije se kompania ajrore me të cilën u deportuan gjashtë shtetasit turq kishte gënjyer institucionet e Kosovës për qëllimin e fluturimit. Gjonbalaj ka pohuar se leja ishte kërkuar për fluturim komercial duke thënë se institucioni që ai drejton nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces. "Ne e dimë se kërkesa për fluturim është bërë në Ministri të Infrastrukturës si fluturim komercial. Kompania ka gënjyer për qëllimin e fluturimit", ka deklaruar Gjonbalaj gjatë raportimit për vitin 2017 para Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Po ashtu, Gjonbalaj ka thënë se janë duke shikuar mundësinë e ndërmarrjes së masave ndaj kompanisë e cila bëri transportimin e gjashtë qytetarëve turq që jetonin në Kosovë të cilët u deportuan me kërkesë të Turqisë, pasi akuzoheshin për pjesëmarrjen në tentim grushtshtetin e vitit 2016.

Gjonbalaj ka thënë se kompania "Birlisik Insaat" mund të përballet me një dënim deri në një milion euro. Më 29 mars, me kërkesë të autoriteteve

turke, Policia e Kosovës kishte arrestuar dhe dëbuar për në Turqi gjashtë qytetarë turq, pesë prej tyre punonjës në shkollën "Mehmet Akif", ndërsa i dëbuar i gjashtë ishte mjek turke.

Për këtë deportim, presidenti, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës patën deklaruar se nuk kanë qenë të informuar paraprakisht. Autoritetet e sigurisë në Kosovë i kishin deportuar ata nën arsyetimin se këta persona paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare. Atyre fillimisht ua revokuan të drejtën e qëndrimit, më pas i deportuan nga Kosova për në Turqi, në bashkëpunim me inteligjencën turke.

Pas deportimit të tyre, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, kishte liruar nga detyra ministrin e Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, edhe drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Driton Gashi.

Shkollat "Mehmet Akif" në Kosovë i përkasin Institucionit Arsimor Gylistan. Ky i fundit ka kopshte, institucione parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme në gjithë Kosovën. (REL)



## Arta Rama-Hajrizi edhe një mandat në krye të Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 22 MAJ (ER) - Në seancën administrative të mbajtur më 22 maj, në përputhje me nenin 114, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kanë votuar

kryetaren aktuale Arta Rama-Hajrizi për një mandat të dytë në krye të Gjykatës Kushtetuese. "Kryetarja Rama-Hajrizi do ta fillojë mandatin e ri në krye të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, më 26 qershor,

kur edhe përfundon mandati i saj i parë", është thënë në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Mandati i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është tri vjet.



## Rritet vëllimi i punës në shërbimin e Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive

EPOKA ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 22 MAJ - Funkcionalizimi 24 orësh i shërbimit të Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive, në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ka bërë që vëllimi i punës të rritet dukshëm dhe të shënohen rezultate që kanë reduktuar listat e pritjes. Kështu është bërë me dije nëpërmjet një komunikate të QKUK-së, në të cilën sqarohet se në Shërbimin e Kardiologjisë Invazive këtë vit janë realizuar 890 koronarografi, 490 procedura intervente-stentime. "Intervenimi është realizuar edhe tek 312 pacientë në fazën akute të infarkt të myokardit. Lista e pritjes për koronarografi, nga 1 052 pacientë sa ka qenë para funksionalizimit 24 orësh, ka zbritur në më pak se 500, ndërkohë që prej javës së ardhshme fillojnë të ftohen

pacientët që kanë bërë terminet si raste joemergjente gjatë vitit 2018. Ndërkohë, nga 102 pacientë që ishin në listë për stentim, tani janë në pritje 60 pacientë", është theksuar në komunikatën e QKUK-së.

Sipas QKUK-së, gjatë këtij viti në shërbimin e Kardiokirurgjisë janë kryer 80 operime, ndërkohë nga fillimi i punës së menaxhmentit të ri, 100 operimet e para elektive (jourgjente) pa vdekje, 0 % mortalitet. "Lista e pritjes nga 406 pacientë, me pritje nga viti 2015, është reduktuar. Nga janari i këtij viti janë në pritje 120 pacientë", thuhet në komunikatën e QKUK-së, duke shtuar se puna e kryer në këtë shërbim ka kursyer para që shpenzoheshin për mjekim jashtë vendit.

QKUK-ja ka dhënë edhe detaje për hapjen e sallave të reja. "Nga puna e kryer në Kardiokirurgji dhe Kardiologji



Invazive në QKUK janë kursyer tre milionë euro që më parë shkonin për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore. Po bëhen përgatitje intensive për hapjen e sallës së

dytë operative në kardiokirurgji e cila do të ndodhë së shpejti. Krahas kësaj, hapet edhe salla e dytë e mjekimit intensiv me katër shtretër. Janë duke u bërë përgatitje intensive për hapjen e

sallës së dytë të kateterizimit (angiografi-koronarografi i ri), funksionalizimi i saj pritet brenda dy muajve të ardhshëm", është thënë në komunikatën e QKUK-së.

## Kërkohet përpjekje më e madhe për parandalimin e drogave



PRISHTINË, 22 MAJ (ER) - Këshilli Kombëtar Kundër Narkotikëve ka mbajtur të martën takim të radhës, në të cilin është diskutuar implementimi i Strategjisë Kundër Narkotikëve. Në këtë takim u diskutua lidhur me raportet e tremujorit të parë të këtij viti, për të gjitha institucionet të cilat janë të përfshira në përmbylljen e objektivave të përgjithshme të Strategjisë Kundër Narkotikëve.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra, i cili është e koordinatori i kësaj strategjie, ka vlerësuar grupin punues për punën e bërë deri

më tani, në veçanti ka falënderuar organet e ndjekjes penale, me theks të veçantë Policinë e Kosovës për luftimin e kësaj dukurie negative.

Koordinatori Shkodra ka kërkuar nga të gjithë aktorët e përfshirë që të bëjnë përpjekje maksimale për luftimin e kësaj dukurie, në mënyrë që të këtë sa më pak kontakt të qytetarëve me të gjitha llojet e drogave.

Grupi punues ka vlerësuar se luftimi i kësaj dukurie ka arritur suksese, por duhet të bëhen përpjekje edhe më të mëdha për luftimin dhe parandalimin e drogave.

## Shtyhet seanca e Kuvendit, LDK-ja kërkon zgjedhje

PRISHTINË, 22 MAJ (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije se është shtyrë seanca e

Kuvendit, e cila është paraparë të mbahet sot (e mërkurë). Me këtë rast ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës është bërë jofunksional. "Seanca e

nesërme e Kuvendit shtyhet. Kuvendi është bërë jofunksional. Kuvendit i ka humbur kuptimi si institucioni më i lartë i shtetit. Është urgjente

funksionalizimi i institucioneve legjitime përmes zgjedhjeve të lira e demokratike", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".





## PAN-i vonon emërimin e anëtarëve të ri të KQZ-së

Tri partitë në pushtet ende nuk i kanë dërguar nominimet e tyre te presidenti për anëtarë të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ani pse anëtarëve aktualë u ka kaluar mandati. Gazeta "Epoka e re" nga burimet brenda koalicionit PAN ka marrë vesh se vonesat në këtë drejtim janë bërë për shkak të mospajtimeve në mes të AAK-së dhe Nismës. Sipas këtyre burimeve, PDK-në në KQZ do ta përfaqësojë Ilir Gashi, ndërkaq Aleancën dhe Nismën Binak Vishaj. Kurse partitë opozitare i kanë dorëzuar nominimet e tyre. LDK-ja do të përfaqësohet nga Sami Hamiti e Florian Dushi, kurse Vetëvendosja nga Adnan Rrustemi e Nazlie Bala

sekretari i përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka mohuar mundësinë të ketë mospajtim në mes të Aleancës dhe Nismës sa i përket nominimit të anëtarit në KQZ. Ai ka thënë të martën për gazetën "Epoka e re" se shumë shpejt do ta dërgojnë nominimin e tyre te presidenti. "Unë nuk e di që ka pasur mosmarrëveshje në mes të Aleancës dhe Nismës, mirëpo ende nuk kemi marrë vendimin për këtë çështje", ka deklaruar Kuçi. Ai nuk ka përfunduar mundësinë që anëtar i aktual Binak Vishaj të jetë edhe për një mandat anëtar i KQZ-së. "Nuk e mohoj mundësinë të jetë serish ai, por ende nuk e kemi marrë vendimin për këtë", ka theksuar Kuçi. Për dallim prej koalicionit PAN, dy partitë e tjera opozitare tashmë i kanë proceduar në Presidencën e Kosovës nominimet e tyre për anëtarë të KQZ-së. Zyrtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se Sami Hamiti dhe Florian Dushi do ta përfaqësojnë këtë parti në KQZ. Kurse Lëvizja

Vetëvendosje (LV) do të përfaqësohet nga anëtar i aktual Adnan Rrustemi dhe nga Nazlie Bala. Katër anëtarë të tjerë të KQZ-së u takojnë komuniteteve pakicë. Për procesin e emërimit të anëtarëve të rinj të KQZ-së ka folur të martën për gazetën "Epoka e re" ish-anëtar i këtij komisioni, Blerim Burjani. Ai ka thënë se është vonuar mjaft shumë zgjedhja e përbërjes së re të KQZ-së dhe, sipas Burjanit, partitë po e vonojnë këtë proces. "Mendoj se është vonuar shumë procesi i emërimit të anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sepse mandati i tyre ka përfunduar më herët. Kjo vonesë po bëhet për shkak se partitë politike nuk i kanë dërguar nominimet e tyre në Presidencë. E di se ka probleme në mes të PAN-it, përkatësisht në mes të Aleancës dhe Nismës sa iu përket nominimeve. Aleanca dhe Nisma kërkojnë të kenë nga një anëtar në KQZ, por kjo nuk është e mundur, meqë ligji nuk e lejon. Tentativat e tilla duhet të ndërpriten sepse këto e kanë bllokuar deri më tash nominimin e anëtarëve të rinj të KQZ-së", ka deklaruar ai, duke shtuar

se po bëhet përpjekje që partitë t'i nominonjë kandidatët e njëjtë të cilët e kanë kaluar kuotën ligjore prej dy mandateve si anëtarë të KQZ-së. Burjani ka thënë se Zyra Ligjore e presidentit duhet të ketë kujdes me këtë çështje. "Sipas mendimit tim, këto propozime janë të paligjshme, sepse ka anëtarë aty që janë prej vitit 2007 dhe i kanë shterur të gjitha mundësitë që përsëri të nominohen. Për fat të keq, disa prej partive politike i kanë dërguar emrat e njëjtë. Ky është problem ligjor me të cilin duhet të merret Zyra Ligjore e presidentit e cila duhet të jetë shumë e kujdesshme", është shprehur Burjani. Gazeta ka bërë përpjekje të marrë informacione nga Zyra e presidentit se kur do të emërohet përbërja e re e KQZ-së, megjithatë një gjë e tillë ka qenë e pamundur. Asnjëri prej këshilltarëve të presidentit Hashim Thaçi nuk ka dashur të flasë për këtë çështje, kurse drejtori ligjor s'ka pasur qasje në telefon. Në fund të muajit prill presidenti Hashim Thaçi pati emëruar Valdete Dakën edhe për një mandat në krye të KQZ-së.

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 MAJ - Ndonëse anëtarëve aktualë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) u ka përfunduar mandati, presidenti Hashim Thaçi ende nuk i ka emëruar anëtarët e rinj për shkak se jo të gjitha partitë politike i kanë dërguar në Presidencë nominimet për anëtarë të KQZ-së. Është pikërisht koalicioni fitues i zgjedhjeve parlamentare të 11

qershorit, koalicioni PAN, i cili ende nuk i ka dërguar dy emrat e tij për anëtarë të KQZ-së. Gazeta "Epoka e re" nga burimet brenda këtij koalicioni ka marrë vesh se vonesat në këtë drejtim janë bërë për shkak të mospajtimeve në mes të AAK-së dhe të Nismës. Po sipas këtyre burimeve, në kuadër të PAN-it, Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) në KQZ do ta përfaqësojë edhe për një mandat anëtar i aktual Ilir Gashi, kurse Aleancën dhe Nismën Binak Vishaj. Por,

## Studentët hapën ekspozitë në Ditën Botërore të Biodiversitetit



Prorektori i UHZ-së, Afrim Selimaj, ka thënë se ky universitet është i gatshëm të kontribuojë në iniciativë të tilla mjedisore. Ndërsa zëvendësministri i MMPH-së, Fatmir Matoshi, është zotuar për zbatimin e Planit të veprimit për ruajtjen e biodiversitetit.

PEJË, 22 MAJ (ER) - Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" (UHZ), në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe nën organizim të përbashkët me organizatat joqeveritare mjedisore "ERA", "FINQ", "KEERC", si dhe shoqërinë civile, kanë shënuar të martën Ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit. Prorektori i UHZ-së, Afrim Selimaj, ka thënë se ky universitet është i

gatshëm të kontribuojë në iniciativë të tilla mjedisore. Ndërsa zëvendësministri i MMPH-së, Fatmir Matoshi, është zotuar për zbatimin e Planit të veprimit për ruajtjen e biodiversitetit. Ai ka thënë se shkatërrimi i lumenjve dhe pyjeve është degradim edhe i jetës dhe të ardhmes sonë të përbashkët. Ndërsa përfaqësuesi i organizatës "FINQ", Nexhmedin Ramadani, ka folur për bukuritë e zonës së Dukagjinit, në veçanti për

zogjtë, ku kjo organizatë ka për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Fatos Lajçi nga "ERA" ka thënë se Kosova nuk qëndron mirë në fushën e biodiversitetit, sidomos në zonat e mbrojtura dhe në parqet kombëtare. Pas fjalës së tij, Lajçi ka ftuar të pranishmit për ta përfunduar shtegun e zogjve, në afërsi të hapësirës universitare në parkun e qytetit, që njihet për llojllojshmërinë e zogjve që jetojnë në qytetin e Pejës.

# Përrurohet rruga që lidh Kosovën dhe Shqipërinë

## "Epoka e re"

**DRAGASH, 22 MAJ** - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, bashkë me shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë, Nataliya Apostolova, ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi dhe kryetarin e Dragashit, Shaban Shabani, kanë përruar të martën rrugën Krushevë - Shishtavec, e cila lidh Kosovën me Shqipërinë. Limaj në emër të Qeverisë së Kosovës ka falënderuar Bashkimin Evropian për këtë investim. Ai ka thënë se ndërtimi i kësaj rruge do t'i ndihmojë qytetarët e kësaj zone. "Komunitetit të kësaj zone me këtë rrugë do t'u lehtësohet jo vetëm qarkullimi, por edhe bashkëpunimi i ndërsjellë. Financimi i kësaj rrugë nga miqtë ndërkombëtarë tregon se ata i shohin nevojat e njerëzve tanë në çdo cep të vendit", ka

thënë Limaj. Më tutje, zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se shpreson që herën tjetër kur të vijë në këtë vend do të vijë për të përruar ndonjë fabrike. Ai ka apeluar te banorët andej dhe këndej kufirit që t'i shfrytëzojnë këto mundësi për të gjeneruar punë dhe për të tjerët. Ndërsa shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova, ka thënë se është e lumtur që ka ardhur për ta shënuar së bashku përfundimin e ndërtimit të rrugëve që lidhin Kosovën dhe Shqipërinë. "Të dy vendet në programin e tyre të bashkëpunimit ndërkufitar kanë identifikuar si prioritet përmirësimin e infrastrukturës rrugore në këtë zonë kufitare. Njëpërmjet fondeve të BE-së dhe zyrtarëve të BE-së në Shqipëri dhe Kosovë këto nevoja të identifikuar të infrastrukturës tani zbatohen", ka thënë Apostolova.



## Gërxhaliu: 'Fondacioni Jahjaga', mundësi e përmirësimit të imazhit të Kosovës



**PRISHTINË, 22 MAJ (ER)** - Oda Ekonomike e Kosovës ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me "Fondacionin Jahjaga", i cili ka për qëllim fuqizimin ekonomik të grave të marginalizuara si dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik të vendit. Nga ky bashkëpunim fillimisht do të përfitojnë dhjetë gra nga Gjakova dhe Drenasi. Kryetari i Odës Ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se "Fondacioni Jahjaga" është

mundësi për zhvillimin ekonomik dhe në funksion të përmirësimit të imazhit të vendit. "Besoj se një fondacion i tillë do të jetë siguri për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Një bashkëpunim i tillë do të jetë në funksion të përmirësimit të imazhit të vendit. Ky memorandum do të jetë një mundësi e përshpejtimit të proceseve të integruese", ka thënë Gërxhaliu. Drejtori ekzekutiv i "Fondacionit Jahjaga", Alban Bokshi, ka thënë

se shpreson se bashkëpunimi në mes të Odës Ekonomike të Kosovës dhe fondacionit të vazhdojë. Ai ka falënderuar OEK-un për ndihmën që i kanë ofruar këtij fondacioni. "Qëllimi i projektit tonë është fuqizimi ekonomik i grave të marginalizuara. Projekti do të ndihmojë pesë gra në Drenas dhe pesë në Gjakovë. Ky memorandum është i vlefshëm për të vënë bazë në bashkëpunimin e OEK-ut dhe fondacionit tonë", ka thënë ai.

## Tahiri: Fuqizimi i sundimit të ligjit, parakusht për zhvillimin e bizneseve

Ministri Tahiri ka thënë se problemet e deritashme të bizneseve të cilat ndërlihen me drejtësinë nuk janë të vogla. Sipas tij, pikërisht për këtë arsye është filluar me një reformë të rëndësishme që ndërlihet me gjykatat të cilat ndajnë drejtësi për bizneset.

**PRISHTINË, 22 MAJ (ER)** - Fuqizimi i sundimit të ligjit është parakusht themelor për një biznes të shëndetshëm dhe të zhvilluar në Republikën e Kosovës. Kështu ka thënë të martën në Mitrovicë ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, gjatë takimit me përfaqësuesit e Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Odës Ekonomike Amerikane dhe me bizneset nga rajoni i Mitrovicës.

Ministri Tahiri ka thënë se problemet e deritashme të bizneseve të cilat ndërlihen me drejtësinë nuk janë të vogla. Sipas tij, pikërisht për këtë arsye është filluar me një reformë të rëndësishme që ndërlihet me gjykatat të cilat ndajnë drejtësi për bizneset. Ai ka theksuar çështjen nëse Kosovës i nevojitet një gjykatë komerciale, për të cilën ka thënë se është duke u trajtuar me shumë vëmendje nga ekspertë vendorë e ndërkombëtarë.





# Konkurrenca jolojale, top barrierë e të bërit biznes



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 22 MAJ** - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka prezantuar të martën rezultatet e studimit "Bottleneck", me qëllim identifikimin e barrierave që pengojnë të bërit biznes në Kosovë.

Kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka thënë se ajo çfarë shihet nga të gjeturat e studimit është se mungesa e funksionimit të ligjit është emëruesi i përbashkët, që sjell problemet në aktivitetin ekonomik në vend. Sipas tij, fokusimi i politikës kosovare në demarkacion, asociacion dhe liberalizim e kanë ngulfatur zhvillimin ekonomik. "Të gjeturat janë

produkt i dialogut në mes të OEK-ut dhe bizneseve. Në kohën kur agenda politike është e ngarkuar mbetet pak hapësirë për aktivitete ekonomike. Është fjala demarkacion, asociacion dhe termi liberalizim. Kjo e ka ngulfatur ekonominë", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se ajo çfarë shihet nga të gjeturat e studimit është se mungesa e funksionimit të ligjit është emëruesi i përbashkët "nëse s'ka forcim do të jetë e pamundur të eliminohet ekonomia joformale". Ai ka thënë se integrimi ekonomik është parakusht për integrimin politik.

Përfaqësuesja e Departamentit të Analizave në OEK, Olivera Ceni-Bardiqi, ka prezantuar të gjeturat e studimit. Sipas saj, 61

për qind e bizneseve e shohin si top barrierë konkurrencën jolojale nga ekonomia e hirtë. "Kostoja e energjisë elektrike 51 për qind, kamatat e larta dhe kostot shtesë për transaksionet bankare 38 për qind, mungesa e parasë së gatshme 32.5 për qind dhe mungesa e fuqisë punëtore e shkathtë 31.6 për qind", ka thënë ajo.

Për 37,8 për qind të bizneseve joqëndrueshmëria politike po ashtu zë vend në mesin e barrierave, pasuar nga korrupsioni 28.5 për qind, që në vitin 2017 u cilësua si një nga barrierat kryesore për bizneset e Kosovës.

Sytrime Dervisholli nga Departamenti i Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka bërë me dije se

energja elektrike mbetet pengesë për zhvillimin e biznesit në vend. "Një ndër barrierat, energja elektrike, mbetet shqetësuese për bizneset. Kemi pasur raste që për këtë shkak ka pasur edhe mbyllje të fabrikës", ka thënë Dervisholli, duke shtuar se Kosova ka krijuar mekanizmat për tregti të lirë.

Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Sakip Imeri, ka thënë se sado që është bërë punë për zvogëlimin e informalitetit, kjo mbetet pengesë për tatimpaguesit. Sipas tij, kjo dukuri dëmton bizneset, buxhetin e shtetit dhe ndikon në dobësimin e aktivitetit biznesor në vend.

Kurse drejtori në Doganën e Kosovës, Bahri Berisha, ka

pohuar se sfida për ta mbetet ekonomia joformale, sidomos në pjesën veriore të vendit. Sipas tij, kontrabanda që është duke u zhvilluar atje përmes vijës së gjelbër është shumë më e vogël. "Besoj se gjatë këtyre viteve Dogana ka bërë hapa pozitivë për krijimin e lehtësirave tregtare, por normalisht se ka hapësirë për përmirësime. Por, pavarësisht çfarë kemi bërë deri sot, ka nevojë ende për të bërë", ka thënë ai.

OEK-u si përfaqësuesi kryesor i komunitetit të biznesit do t'i paraqesë të gjeturat e Qeverisë së Kosovës dhe të institucioneve relevante, në mënyrë që të gjithë së bashku të mund të punojmë për përmirësimin e klimës së biznesit në Kosovë.

## Beqaj: Parku për Inovacion në Prizren do të jetë katalizator i zhvillimit ekonomik

**PRIZREN, 22 MAJ (ER)** - Të martën është mbajtur takimi i Komitetit të Përkohshëm Drejtues për Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren.

Në hapje të këtij takimi ka marrë pjesë edhe ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, i cili ka thënë se ky park do të jetë një nga katalizatorët e zhvillimit ekonomik të vendit përmes fuqizimit të rinisë dhe ndërkombëtarizimit të Kosovës. "Përkushtimi im është që ky Park të jetë një nga katalizatorët e zhvillimit ekonomik të vendit, fuqizimit të rinisë dhe ndërkombëtarizimit të

Kosovës në ekonominë globale digjitale", ka deklaruar Beqaj. Takimi i radhës i Komitetit të Përkohshëm Drejtues për Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve është mbajtur në kuadër të përgatitjeve për funksionalizimin e tij që pritet të bëhet në fillim të vitit 2019. Ky Park do të funksionalizohet në hapësirën që është shfrytëzuar nga KFOR-i gjerman në Prizren si dhe do të jetë mundësi për zhvillim ekonomik të Kosovës përmes krijimit të hapësirës për të rinjtë dhe ndërkombëtarizimit të Kosovës në ekonominë digjitale. Parku pritet të jetë i hapur edhe për të rinjtë nga vendet e rajonit.



## 'Shaban Jashari' në Skenderaj shënon ditën e shkollës

SKENDERAJ, 22 MAJ (ER) - Me rastin e kremtimit të 92-vjetorit të themelimit të kësaj shkolle dhe 94-vjetorit të lindjes së heroit të kombit Shaban Jasharit, të cilin emër e mban kjo shkollë, për këto dy festa kjo shkollë ka organizuar një sërë aktivitete promovuese dhe kulturore në shënim të kësaj dite. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin kryesuesja e kuvendit komunal, Fatbardha Haliti, drejtori i Arsimit, Bekim Latifi, përfaqësuesi i familjes Jashari, Rifat Jashari, si dhe

mësimdhënës, prindër, nxënës dhe ish-mësimdhënës të shkollës.

Në fjalimet që u mbajtën në këtë ngjarje u theksua se kjo shkollë ka fatin ta mbajë emrin e njërit prej mësuesve më të dalluar në Drenicë e më gjerë, atë të Shaban Jasharit dhe babait të Adem dhe Hamëz Jasharit. Pas përfundimit të programit kulturor-artistik të përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle u zbulua edhe busti i heroit Shaban Jashari.



## Bytyqi premtan mbështetje për Komunën e Kaçanikut

KAÇANIK, 22 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka vizituar të martën Komunën e Kaçanikut, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune, Besim Ilazi. Në këtë takim Bytyqi e Ilazi kanë biseduar për gjendjen aktuale të arsimit në Kaçanik dhe punët që duhet të bëhen për ngritjen e cilësisë së arsimit. Ministri Bytyqi i ka ofruar mbështetje

ilazit për përafrim sa më të madh të bashkëpunimit me nivelin lokal në Kaçanik në mënyrë që t'i qasen zgjidhjes së problemeve arsimore në nivelin lokal. Po ashtu, ai ofroi mbështetje edhe për përmirësimin e infrastrukturës në shkollat e Kaçanikut. Ndërsa kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, e ka vlerësuar lart vizitën e ministrit Bytyqi, derisa është shprehur

mirënjohës për mbështetjen që ky i fundit ka ofruar për ngritjen e cilësisë së arsimit dhe për përmirësimin e infrastrukturës në këtë komunë.

Ministri i MASHT-it, Shyqiri Bytyqi dhe kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, kanë vizituar Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Jusuf Gërvalla" në Biqec si dhe Shkollën e Mesme "Feriz Guri dhe Vëllezërit Qaka".

## KPF-ja jep 24 rekomandime për Kuvendin Komunal të Malishevës

MALISHEVË, 22 MAJ (ER) - Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) në Komunën e Malishevës kanë mbajtur mbledhjen e tretë të radhës, e cila është drejtuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal të kësaj komune, Rrahim Morina.

Në këtë mbledhje KPF-ja ka shqyrtuar kërkesën për procedurë të mëtejme për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të hapësirave publike për vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës. Po ashtu, është shqyrtuar dhe miratuar kërkesa për shqyrtimin e draftplanit të



Integritetit të Komunës së Malishevës për vitet 2018-2020. Anëtarët e KPF-së shqyrtuan edhe kërkesën për marrjen e vendimit në lidhje me miratimin e draftdokumentit, Plani i

veprimit për Transparencë në Komunën e Malishevës për vitin 2018. "Gjithashtu u shqyrtua propozimi nr. 01/649, datë 27. 4. 2018, i parashtruar nga kryetari i komunës për shpalljen në interes publik të pronave private, sipas elaboratit të shpronësimit (e përsëritur); shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 11/394, datë 20. 4. 2018, e parashtruar nga DKAË në Malishevë për ta përkrahur financiarisht pagesën e tri pagave përcjellëse për personelin arsimor të cilët janë pensionuar në vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018, si dhe kërkesa nr. 01/596, datë 20. 4.

2018, e parashtruar nga menaxheri i personelit në KK Malishevë për ta përkrahur financiarisht pagesën e tri pagave përcjellëse për zyrtarët e administratës të cilët janë pensionuar në vitin 2014 dhe 2018", është thënë në njoftimin e Komunës së Malishevës.

Anëtarët e KPF-së miratuan edhe projektregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2018. Komitetit për Politikë dhe Financa ka rekomanduar taksa të ndryshme për biznese të njëjta me specifikacionin që përcakton lokacionin.

## Mitrovica krijon mundësi të mjaftueshme për parkim të automjeteve

Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, Naser Muja, ka bërë me dije se tashmë është lëshuar për shfrytëzim të qytetarëve parkingu për automjete në objektin e ri afarist (biznesor), ngjitur me Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica", afër urës kryesore mbi lumin Ibër.

MITROVICË, 22 MAJ (ER) - Komuna e Mitrovicës është në rrugë të mbarë për ta zgjedhur problemin e parkimit të automjeteve të qytetarëve në qendrën e qytetit.

Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike, Naser Muja, ka bërë me dije se tashmë është lëshuar për shfrytëzim të qytetarëve parkingu për automjete në objektin e ri afarist (biznesor), ngjitur me Qendrën e Kulturës

"Rexhep Mitrovica", afër urës kryesore mbi lumin Ibër.

Muja ka thënë se kapaciteti i parkingut të ri është për mbi 100 automjete, ndërsa çmimi për parking është i volitshëm për qytetarët, vetëm një euro, pa marrë parasysh kohëzgjatjen e parkimit. Po ashtu, drejtori Muja ka njoftuar qytetarët se është lëshuar për shfrytëzim të qytetarëve edhe parkingu ngjitur me tregun e gjelbër, përballë stadiumit të futbollit "Rizah

Lushta", me kapacitet prej 200 vendeve për parkim të automjeteve. Kurse çmimi i parkimit të automjetit në këtë parking është 0.30 cent për një orë. "Një parking tjetër shumë i përshtatshëm për qytetarë, me mbi 50 vende parkimi, është ai ndërmjet Shkollës së Muzikës 'Tefta Tashko' dhe shkollës 'A. Z. Çajupi'. Çmim është një euro për një orë", ka thënë Muja. Ai ka shtuar se atyre që çmimi i parkimit u duket i lartë, kanë



mundësi që automjetin e tyre ta parkojnë pa pagesë në parkingun me kapacitet prej 200 automjeteve, afër kom-

panisë së mbeturinave "Uniteti", përkatësisht në vendin ku më parë kanë qenë garazhet e "Kosovatrans"-it.

# Përkujtohet masakra e Dubravës



**ISTOG, 22 MAJ (ER)** - Të martën është shënuar 19-vjetori i masakrës së Burgut të Dubravës, e cila ka ndodhur në mes datave 19-24 maj 1999. Kjo masakër cilësohet një nga më të mëdhatë kundër shqiptarëve që ndodhën në Kosovë.

Të mbijetuarit dhe familjarët e të vrarëve kanë bërë homazhe në ambientet e burgut aty ku 19 vjet

më parë u vranë 160 të burgosur. E pranishme ishte edhe kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi, Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Duda Balje, anëtarë të tjerë të këtij komisioni Mexhide Mjaku-Topalli, Teuta Haxhiu, Saranda Bogujevci etj. Ndërsa para të pranishëmve kanë folur të mbijetuarit e kësaj masakre, deputeti

Nait Hasani dhe drejtori i gazetës "Epoka e re", Sadik Zeqiri.

Këtë ngjarje e ka kujtuar edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ai ka thënë se kjo ngjarje përbën një nga tragjeditë më të mëdha, autorët e së cilës ende janë të lirë.

"Në përvjetorin e masakrës në Burgun e Dubravës i kujtojmë të

gjithë të burgosurit shqiptarë që përjetuan jo vetëm persekutime sistematike, por edhe vrasje mizore nga forcat policore serbe. Duke pasur informacione se ky burg do të sulmohej prej forcave veri-atlantike, autoritetet serbe ato ditë kishin ekstraduar shumë të burgosur shqiptarë në këtë burg, për t'i vrarë dhe për t'ua veshur fajin forcave të NATO-s.

Masakra e Dubravës është një prej tragjediave më të mëdha, autorët e së cilës ende nuk dolën para drejtësisë", ka shkruar Thaçi.

19 vjet më parë brenda burgut janë vrarë 160 të burgosur shqiptarë dhe janë plagosur më shumë se 300 të tjerë. Masakra e Burgut të Dubravës është kryer prej 19 deri më 24 maj të vitit 1999.

## OSBE-ja ofron mbështetje për zyrën e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje

**PRISHTINË, 22 MAJ (ER)** - Zëvendësministri i Drejtësisë, njëherësh koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje, Naim Qelaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu. Gjatë këtij takimi zëvendësministri Qelaj ka falënderuar ambasadorin Braathu për bashkëpunimin e deritanishëm që ky mision ka me Ministrinë e Drejtësisë në segmente të caktuara, përfshirë edhe aktivitetet me të cilat është e angazhuar Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje. Zëvendësministri Qelaj ka njoftuar ambasadorin Braathu me të arriturat dhe rezultatet e Republikës së Kosovës në përgjithësi në fushën e sundimit të ligjit si dhe për hapat konkretë të cilat janë duke i ndërmarrë si zyrë. Ai ka thënë se në kuadër të mandatit si Koordinator Nacional Kundër Dhunës në Familje ka parë të nevojshme krijimin e mekanizmeve adekuatë për parandalimin e dhunës në familje, si nevojë



për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Dhunës në Familje.

Qelaj ka thënë se mbeten të angazhuar për zgjidhjen e financimit të qëndrueshëm për strehimoret e viktimave, që vlerësohet me rëndësi për mbarëvajtjen e aktiviteteve kundër dhunës në familje, krijimin e databazës për rastet e dhunës në familje, si dhe krijimin e një mekanizmi për raportim periodik të dhunës në familje me qëllim të informimit të saktë dhe llogaridhënies. Ndërsa ambasadori Braathu ka

falënderuar zëvendësministrin Qelaj për angazhimin në këtë proces si dhe ka shprehur gatishmërinë e misionit të OSBE-së për të bashkëpunuar në hapat konkretë të cilët i ka prezantuar zëvendësministri Qelaj. Ambasadori ka theksuar se çështjet e lartpërmendura janë në interes edhe të misionit të OSBE-së dhe për këtë mbeten të përkushtuar për thellimin e këtij bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, konkretisht me Zyrën e Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje.

## Nderohen 77 të vrarët e masakrës së 22 majit në Vushtrri

**VUSHTRRI, 22 MAJ (ER)** - Të martën janë përkujtuar 77 të vrarët e masakrës së 22 majit në Komunën e Vushtrrisë. "Sot 19 vjet pas kësaj plage të rëndë të luftës qyteti i Vushtrrisë nderon martirët që dhanë jetën për liri. Të gjitha këta njerëz të mirë të Vushtrrisë e të Kosovës u vranë vetëm për një arsye: ata ishin shqiptarë, refuzuan nënshkrimin dhe refuzuan ta brak-

tisin tokën e tyre, shtëpitë e tyre. Ata si i gjithë populli i Kosovës e kishin kuptuar se regjimi i Millosheviqit kishte synim dëbimin dhe spastrimin trojeve etnike shqiptare, prandaj vendosën të qëndrojnë e me gjakun e tyre dhe me jetën e tyre njomën lirinë e pavarësinë e Kosovës", ka thënë kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri.



## Asfaltohen disa rrugë në Barilevë

**PRISHTINË, 22 MAJ (ER)** - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se ka përfunduar asfaltimin e disa

rrugëve dhe rrugicave në lagjen Vërbovc të Barilevës. "Si në qytet, ashtu edhe në fshatra, po

investojmë për përmirësimin e kushteve infrastrukturore. Sapo ka përfunduar asfaltimi i disa

rrugëve dhe rrugicave në lagjen Vërbovc të Barilevës", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



**E jashtëzakonshme**


# Vdes rrugëve si e pastrehë, la një milion euro në bankë

Banorët e njhnin prej vitesh gruan me duar të gjymtuara e cila jetonte në rrugët e qytetit, por nuk e dinin se kishte rreth një milion euro në bankë. Fatima Othman nga një qytezë e vogël në Liban u gjymtua gjatë luftës civile (1975-1990) dhe humbi jetën në moshën 52-vjeçare. Policia u habit kur i gjeti, mes plaçkave, një qese me rreth 3 000 dollarë, por u habit edhe më shumë kur i



kontrolloi emrin në bankë dhe doli se ajo kishte rreth një milion euro të trashëguara në një llogari bankare.

**FOTO E DITES**



Një grua myslimane lutet në Xhaminë Istiqlal në Xhakarta, Indonezi. /AP/

**E rrallë**

# Gruaja më e vjetër në botë që pritet të bëhet nënë

Maria de la Luz, e cila tashmë është në moshën 70-vjeçare, pretendon se është në muajin e gjashtë të shtatzënisë, duke pritur fëmijën e tetë, por kjo ende nuk është konfirmuar. 70-vjeçarja u ka thënë gazetarëve se pret një vajzë,



duke u treguar "EKO"-n me ultratinguj. Nëse pretendimet e saj janë të vërteta, atëherë do të bëhet nëna më e vjetër në botë.

**BARSOLETA E DITËS**



- **Doktori:** Duhet të merresh me sport që të kesh shëndet më të mirë.
- **Djali:** Për çdo ditë luaj futboll, basketboll, tenis...
- **Doktori:** Sa orë në ditë luan?
- **Djali:** Derisa t'i mbarojë bateria telefonit.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

## “AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo



**Në ora 18:00**

## “ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson



**Në ora 16:00 dhe 20:00**

## “DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

**Regjia:** David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do të shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




**Në ora 22:00**

## “I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**  
Hëna në shenjë vazhdon t'ju

favorizojë dhe niveli juaj i entuziazmit është mjaft i lartë. Do të jetë ngjites edhe për personat rreth jush.



**DEMI**  
Keni mjaft intuitë sot sa i përket fushës së

ekonomisë dhe do të dini t'i dalloni mirë situatat që mund t'ju sjellin të ardhura të kënaqshme.



**BINJAKËT**  
Fillon një periudhë shumë e bukur për

të gjithë të lindurit e kësaj shenje. Do të spikasni kudo e në çdo ambient dhe ju do të merrni në dorë situatën.



**GAFORRJA**  
Po vini në provë të

vështirë durimim e personave që janë pranë jush. Edhe pse e bëni në mënyrë të pandërgjegjshme, keni kompromentuar raportet.



**LUANI**  
Po shpikni shumë

justifikime për të shtyrë në kohë një detyrë që duhet ta mbyllnit. Gjithsesi përgjegjësia përsëri do të bjerë mbi ju.



**VIRGJËRESHA**  
Keni nevojë për pak

qetësi dhe më shumë argëtim për ta harruar ngarkesën e madhe në punë që ju karakterizon gjithmonë këtë periudhë.



**PESHORJA**  
Keni humbur harmoninë që ju

karakterizonte në raportin me partnerin dhe do t'ju duhet pak kohë sa ta rivendosni qetësinë e dikurshme.



**AKREPI**  
Po shihni me imtësi se çfarë

ndodh rreth jush dhe nuk dëshironi të bëheni pjesë e kompromiseve të ulëta.



**SHIGJETARI**  
Merrni në konsideratë atë që ju thonë me

të mëdhenj se ju në moshë. Nga përvoja duhet t'i dëgjoni.



**BRICJAPI**  
Keni shumë dyshime që bëni

mirë t'i sqaroni dhe të mos i bluani me veten. Do të krijoni më tepër keqkuptim duke u menduar shumë.



**UJORI**  
Keni harxhuar më tepër

kohë sesa duhet për t'i përfunduar projektet tuaja, por tani jeni të sigurt se keni bërë çdo gjë siç duhet deri në detaje.



**PESHQIT**  
Po përballoni më së miri

ngarkesën e ditës dhe në orët në vijim vendimet që do të merrni do ta reflektojnë gjendjen tuaj.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SLUTSK - DINAMO BREST

GG3+

CELJE - MARIBOR

GG3+

HACKEN - AIK STOCKHOLM

GG3+

## Hashani zyrtarizon pensionimin, pritet edhe Dragusha



Futbolli i Kosovës do të mbetet pa dy yje, të cilët kanë pasur një karrierë të pasur në Kosovë dhe Shqipëri. Bëhet fjalë për mbrojtësit Erdin Hashani dhe Alban Dragusha. "Futbolli më mësoj sa e vështirë është të punosh dhe të sakrifikosh shumë për të arritur diçka. Ëndrra ime nuk ishte të bëhesha milioner, por një futbollist i mirë. Unë gjithmonë e djersita fanellën time. Këtë duhet ta bëni edhe ju", ka thënë Hashani

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 MAJ - Ylli i futbollit të Kosovës, Erdin Hashani, ka vendosur që nesër (e enjte) t'i thotë lamtumirë lojës së futbollit, pas një karrierë të pasur 18-vjeçare. Hashani, i cili është ndër lojtarët më të mirë në futbollin e pasluftës, ka vendosur që lajmin për pensionim të bëjë nëpërmjet faqes zyrtare në "Facebook". Ai ka falënderuar të gjitha klubet ku ka luajtur, tifozët e tyre dhe trajnerët me të cilët ka punuar. Me këtë rast futbollisti që ka luajtur edhe për Përfaqësuesen e Kosovës dhe ka pasur karrierë edhe në futbollin shqiptar ka thënë se ëndrra e tij nuk ka qenë asnjëherë të bëhet milioner, por një futbollist i mirë. "Futbolli më mësoj sa e vështirë është të punosh dhe të sakrifikosh shumë

për të arritur diçka. Ëndrra ime nuk ishte të bëhesha milioner, por një futbollist i mirë. Unë gjithmonë e djersita fanellën time. Këtë duhet ta bëni dhe ju", ka thënë Hashani.

Erdin Hashani në karrierën e pasur futbollistike ka luajtur për këto klube: Besëlidhja, KEK-u, Prishtina, Besa, Skënderbeu, Besiana, Trepça, Vëllaznimi, Drita, Hajvalia, Vllaznia dhe Ferizaj. Një tjetër pensionim i një futbollisti të madh pritet të bëhet në finalen e Kupës, kur do të takohen Prishtina - Vëllaznimi. Bëhet fjalë për kapitenin aktual të Vëllaznimit, Alban Dragushën. Ky i fundit kohë më parë për "Epokën e re" kishte konfirmuar se pensionimi do të ndodhë në fund të edicionit 2017/2018. "99 % do t'i jap fund karrierës futbollistike në fund të sezonit. Është një vendim shumë i vështirë për mua, sepse që 20 vjet luaj

futboll profesionist dhe si 16-vjeçar kam debutuar në ekipin e parë, por jam i mendimit se është koha e duhur dhe duhet t'u japim hapësirë gjeneratave të reja", kishte deklaruar Dragusha.

Gazeta të martën ka provuar ta kontaktojë edhe me kapitenin e Drenicës, Sami Gecin, që është lojtari më i vjetër në elitën e futbollit të Kosovës. Kontakti me 43-vjeçarin ka qenë i pamundur, por gazeta ka mësuar se legjenda e Drenicës nuk do të pensionohet dhe se synim i tij është të vazhdojë të jetë futbollist aktiv, pas formës së mirë që ka treguar në kampionatin e sapopërfunduar. Gjithsesi se pensionimi i Erdin Hashanit dhe Alban Dragushës do të sjellë emocione të mëdha në këtë muaj për faktin se ata kanë dhënë shumë për futbollin e Kosovës.

### SHKURT

#### Vushtrria - Flamurtari "luftojnë" për Superligë

Sot (e mërkurë) në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas do të zhvillohet ndeshja e barazhit në mes të Vushtrrisë dhe Flamurtarit. Vushtrria, pas një sezoni të mirë në Ligën e Parë, synon të rikthehet në elitë, por për të bërë një gjë të tillë duhet ta mposhtë skuadrën e Flamurtarit, e cili një vit më parë ishte inkuadruar në Vala Superligë. Ndeshja do të zhvillohet nga ora 16:00.

#### Sonte mund të vendoset titulli në basketboll

Ndeshja e katërt finale në Superligën e Kosovës në basketboll në mes të Bashkimit dhe Prishtinës zhvillohet sonte (e mërkurë) nga ora 21:00. Kjo ndeshje është me rëndësi të madhe, pasi mund ta vendosë edhe titullin e kampionës. Skuadra prizrenase që luan në rolin e skuadrës vendëse, në rast se shënon fitore, do ta festojë titullin e kampionës, pasi aktualisht kryeson 2-1 në serinë finale, dhe skuadra që arrin e para tri fitore shpallet kampionë.

#### Java Evropiane e Sportit do të organizohet sipas standardeve evropiane

Përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, njëherësh drejtuesit e Trupës Kombëtare për organizimin e Javës Evropiane të Sportit, Daut Thaçi, këshilltar për sport i ministrit Kujtim Gashi, Brikena Mulliqi, drejtoreshë e Departamentit të Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Politikave dhe Feim Hoxha, drejtor i Departamentit Ligjor në MKRS, po marrin pjesë në një aktivitet të organizuar nga Komisioni Evropian. Aktiviteti dyditësh po organizohet në Riga të Letonisë lidhur me organizimin e Javës Sportive Evropiane që do të mbahet në fund të shtatorit të këtij viti. Kosova për herë të parë organizon një ngjarje të këtillë. Përfaqësuesit nga Kosova do të marrin përvojat e Letonisë si dhe vendeve të tjera që më parë kanë organizuar këtë ngjarje sportive në mënyrë që Kosova ta organizojë me sukses Javën Evropiane të Sportit.

## Vokrri: Na gëzon rikthimi i KEK-ut në Superligë

PRISHTINË, 22 MAJ - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, ka thënë se inkuadrimi i KEK-ut në Superligë është një lajm i mirë për futbollin e Kosovës, pasi ky

klub është i organizuar mirë dhe kjo i kontribuon futbollit në përgjithësi. Këto komente numri një i FFK-së i bëri të martën gjatë një takimi me kryetarin e KEK-ut, Arben

Shahini. "Inkuadrimi juaj në Superligë neve si FFK na gëzon, sepse synimi ynë është të kemi skuadra të organizuara mirë që reflekton edhe në mbarëvajtjen dhe integritetin e garave", ka

thënë Vokrri. Ndërsa kryetari i KEK-ut, Arben Shahini, e ka falënderuar Vokrrin për pritje dhe me këtë rast e njoftoi për rrugëtimin jo të lehtë drejt rikthimit në Superligë.





Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Shëndetësisë  
 Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health  
 Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

### SHPALLJA E REKRUTIMIT

**Institucioni:** Ministria e Shëndetësisë  
**Departamenti:** Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor  
**Titulli i vendit të punës:** Udhëheqës i Divizionit të Cilësisë dhe Sigurisë së Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësorë  
**Kategoria funksionale/Grada:** Koficijenti - 9  
**Afati i kontratës:** Nëpunës i karrierës – me kohë të pa caktuar  
**Nr. i Referencës:** MSh-13/05/18

#### Detyrat kryesore:

- Menaxhon punën e përgjithshme të divizionit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për divizionin; 15%
- Menaxhon stafin e divizionit dhe në bashkëpunim me mbikëqyrësin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore; 10%
- Në bashkëpunim me drejtorin, bën vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës; 10%
- Monitoron dhe ofron mbështetje në koordinimin e funksionimit të institucioneve shëndetësore duke siguruar cilësi dhe siguri të shërbimeve të kujdesit shëndetësorë në Kosovë; 10%
- Siguron ndërlidhjen e shërbimeve publike dhe private shëndetësore në fushën e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësorë të ofruara nga organizatat qeveritare dhe jo qeveritare (përmes projekteve të ndryshme); 15%
- Ndihmon në hartimin e politikave/strategjive dhe legjisllacionin që ka të bëjë me shërbimet e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësorë; 10%
- Monitoron dhe raporton mbi aktivitetet e shërbimeve për cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësorë; 15%
- Ofron mbështetje në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore në sektorin e shëndetësisë me qëllim të rritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësorë 10%
- Bën vlerësimin e regullit të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara; 5%

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Shkollimi i kërkuar:** Diplomë universitare në mjekësi - dega e mjekësisë e përgjithshme.

#### Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Së paku 5 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri e shkëlqyeshme e kartës së të drejtave të qytetarëve;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me shëndetësinë;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Njohja e punës me kompjuter, programeve: Word-it, Excel-it Power Point-it, Internetet

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Nëpunës i karrierës, pa afat të caktuar.

**Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit:** 23.05.2018 deri 06.06.2018

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren recepcion ose në faqen zyrtare të ministrisë, dhe dorëzohen në zyrën nr. 23 të Ministrisë së Shëndetësisë, Lagja Arbëria, rruga e Zagrebit p.n. (ish Spitali i mushkërive). Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 038 212 -276.

**"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.**

**Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Shëndetësisë  
 Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health  
 Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

### OGLAS ZA REGRUTOVANJE

**Institucija:** Ministarstvo zdravstva  
**Departman:** Departman za zdravstveni strateški razvoj  
**Naziv radnog mesta:** Rukovodilac Divizije za kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite  
**Funkcionalna kategorija/Gradiranje:** Koficijentat- 9  
**Rok ugovora:** Karijerni službenik- na neodređeno vreme  
**Br.reference:** MZ-13/05/18

#### Glavni zadaci :

- Upravlja ukupnim radom Divizije i pomaže direktoru u postavljanju ciljeva i razvoju radnog plana za ispunjavanje ovih ciljeva i izrađuje plan rada Divizije; 15%
- Rukovodi osobljem Divizije i u saradnji sa nadzornikom organizuje poslove preko podele zadataka podređenim zvaničnicima, pruža uputstva i nadgleda rad osoblja kako bi se obezbedili produkti i kvalitetne usluge; 10%
- U saradnji sa direktorom procenjuje procese i unutrašnje procedure i preporučuje izmene i dopune u cilju povećanja poslovnog efikasiteta ;10%
- Nadgleda i pruža podršku u koordinaciji funkcionisanja zdravstvenih ustanova obezbeđujući kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite na Kosovu; 10%
- Osigurava povezanost javnih i privatnih zdravstvenih usluga iz oblasti kvaliteta zdravstvenih usluga koje pružaju vladine i nevladine organizacije (preko raznih projekata); 15%
- Pomaže u izradi politika / strategija i zakonodavstva koje se odnose na kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite; 10%
- Nadgleda i izveštava o aktivnostima službi za kvalitet i bezbednost usluga zdravstvene zaštite; 15%
- Pružna podršku profesionalnom razvoju ljudskih resursa u zdravstvenom sektoru kako bi se povećao kvalitet i poboljšala bezbednost usluga zdravstvene zaštite; ; 10%
- Redovno vrši vrednovanje podređenog osoblja i podržava njihov razvoj preko obuka kako bi se obezbedio nivo zahtevanih standarda u izvršenju poslova; 5%.

**Uslovi učesća u regrutovanju:** Pravo aplikacija imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu poslovnu sposobnost, koji su završili zahtevano školovanje i imaju profesionalnu sposobnost u obavljanju poslova.

**Procedure konkurisanja:** Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate.

**Zahtevano školovanje:** Univerzitetaska diploma iz medicinske oblasti - smer opšte medicine.

#### Sposobnosti / iskustvo i drugi zahtevani atributi :

- Najmanje pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva;
- Odlučno poznavanje povelje o građanskim pravima;
- Poznavanje važećih zakona i pravilnika u vezi sa zdravstvom;
- Sposobnost komuniciranja, pregovaranja i postizanja ubedljivosti u upravljanju;
- Sposobnost u utvrđivanju ciljeva, planiranja rada i analiziranja;
- Sposobnost u rukovođenju i organizovanju ekipe, sposobnost upravljanja ekipom ili radnom grupom;
- Poznavanje rada na kompjuteru u primeni programa: Word, Excel, Power Point, Interneta;

**Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje :** Na osnovu Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi na Kosovu kao i Uredbe br .02/2010 o proceduri regrutovanja u javnoj službi.

**Trajanje imcnovanja:** Karijerni službenik, na neodređeno vreme.

**Datum publikacije i zatvaranja konkursa:** 23.05.2018. do 06.06.2018.

**Prijave aplikacija:** Aplikacije se mogu dobiti na recepciji ili preuzeti sa web stranice ministarstva i dostaviti u kancelariju br. 23 Ministarstva zdravstva na adresi: naselje Arberija, ulica "Zagrebačka" b.b. ( bivša plućna bolnica). U aplikaciji jasno navedite naziv radnog mesta i broj reference. Kontaktirati na telefon : 038 212 -276.

**"Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova, i prima aplikacije od osoba muškog i ženskog roda iz svih zajednica na Kosovu.**

**Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na proporcionalnu zastupljenost u civilnoj službi javne administracije, centralne i lokalne, kako je predviđeno u članu 11, stav 3 Zakona br.03-L-149 o civilnoj službi Republike Kosova".**

Nekompletirane prijave i prijave nakon isteka roka neće se uzimati u obzir. Zbog prevelikog broja primljenih prijava, kontaktiraće se samo oni kandidati koji su izabrani u užem krugu.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, për Departamentin e Shërbimeve të Përgjithshme, bënë:

**Shpallje të konkursit publik  
për marrëveshje për shërbime të veçanta**

Emri i Institucionit:	Ministria e Financave
Njësia Organizative:	Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme
Titulli i punës:	Përkthyes Shqip Anglisht dhe Anasjelltas
Numri i referencës:	04/2018/MF/DSHP
Niveli i pagës:	Paga mujore 480 €
Raporton te :	Drejtori i departamentit
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për shërbime të veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Tre (3) muaj me mundësi vazhdimi edhe deri në tre (3) muaj të tjerë
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Zhvillim dhe arrin pëlqimin për planet e punës të Divizionit të Logjistikes, në fushën e përkthimeve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas;
- Ofron përkthime me shkrim, konsektiv dhe simultan (të gjitha llojet e përkthimit) nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas, sipas kërkesës dhe nevojës së Ministrisë së Financave, (për gjitha strukturat organizative të MF, zyrtarët e MF-së, Projekteve që analizohen në dhe për MF-në) përfshirë shkesat dhe aktet zyrtare, legjislacionin, ueb faqe , përkthimi në takimet e ndryshme, grupe punuese, trajnime, punëtori, konferenca për shtyp , me zyrtar apo institucione – delegacione, etj. Në mënyrë profesionale, brenda afateve kohore të caktuara, sipas standardeve dhe prioriteteve . përkthimi ofrohet brenda dhe jashtë zyrave të MF;
- Lekuron, korrekton dhe kontrollon përkthimet, si dhe punë të ndërlidhura që mund të kërkohen;
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij, për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushën e përkthimit, duke u kujdesur që shërbimi të jetë sa më efikas dhe efektive;
- Bashkëpunon dhe konsultohet me zyrtarët e MF, apo zyrtar tjerë, për ofrimin e shërbimeve të përkthimit, si dhe bashkë koordinon ofrimin e shërbimit;

**Shkathtësitë e kërkuara:** (Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

- Njohuri e shkëlqyeshme e gjuhës angleze dhe shqipe- niveli letrar dhe i hartimit;
- Aftësi për përkthim simultan dhe konsektiv;
- Aftësi për marrjen e vendimeve lidhur me metodat e punës në përputhje me standardet profesionale , pa u konsultuar me zyrtarët e nivelit më të lartë;
- Njohuri në lekturim;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës, koordinim dhe bashkëpunim ;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve ( Word, Excel, Power point, Access);
- Diplomë Universitare- Fakulteti i Gjuhës angleze, minimum 3 vite përvojë pune.

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:**

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

**Procedurat e konkurimit:**

Procedura e konkurimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

**Paraqitja e kërkesave:**

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Financave/Divizioni për Burime Njerëzore, zyra nr. 1207 kati XII, ndërtesa e qeverisë, Sheshi Nëna Tereze, Prishtinë, ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <https://mf.rks-gov.net/>.

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore.  
Tel. 038 200 34 155, prej orës 8:00 – 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **23. 05. 2018 deri më 30. 05. 2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten: kopjet e dokumentacionit për kualifikimin arsimor, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen vendi i punës, për të cilin konkurrohet.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!  
Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit.

Ministria e Financave, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Personelit  
02Br. 111-3634/2018  
Klinë, 22.05.2018

Komuna e Klinës, duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe udhëzimit administrativ nr. 14/11 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, bën shpalljen e:

**KONKURSI PUBLIK**

Për plotësimin e vendit të lirë të punës:

- Mjek i Praksës së Përgjithshme ( 1 ekzekutues) ne QKMF, QMF, AMF

Mbikëqyrësi: Drejtori i QKMF-së " Nëna Tereze" Klinë

Koeficienti – paga: 565.51 €

Kategoria funksionale dhe Grada:

Orari i punës: i plotë sipas Ligjit të Punës

Vendi: Klinë-QKMF, QMF, AMF

Kohëzgjatja e Emërimit: Sipas Ligjit të Punës.

Numri i referencës së vendit të punës: nr. Ref 07/2018

Qëllimi dhe rezultatet:

Te organizoj punën në QKMF, QMF dhe AMF

Detyrat dhe përgjegjësit e mjekut te praksës së përgjithshme:

- mbanë evidencën e dokumentacionit mjekësor,
- jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtime të pacienteve,
- mbanë kujdestarin sipas radhës,
- merri pjesë në hartimin e planit dhe programit të punës,
- përkrahur dhe administrojnë tretmanet , medikamentet dhe aplikon masat tjera ,
- këshillojnë pacientet lidhur me dietën, ushtrimet, higjienën dhe shëndetin në përgjithësi,
- raporton lëndjet, vdekjet dhe sëmundjet ngjitëse tek autoritetet qeveritare.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

përvojë pune:

Shkollimi i kërkuar: Diploma Universitare, Fakulteti i Mjekësisë-drejtimi i përgjithshëm, licencë pune dhe stazhi i obliguar profesional,

Aftësitë dhe përvoja e kërkuar:

- shkathtësi të mira organizative ,
- aftësi për të krijuar raporte të mira ndërpersonale,
- te ketë shkathtësi të shkëlqyeshme të vetorganizimit,
- aftësi për të punuar në ambiente multi-etnike.

Mënyra e Aplikimit:

Formulari për Aplikim mund të merren në Zyrën Komonale të Personelit në Komunën e Klinës aty ku edhe është bërë shpallja e rekrutimit dhe dorëzohen po në të njëjtën zyrë.  
Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Personelit , përmes telefonit fiks 039 471 550 ose telefonit mobil 044/887659.

Shpallja,mbetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik, dokumentet e pakompletuara dhe pas afatit nuk pranohen.  
Ligji i Punës Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Shefi i Personelit  
Xhavit Dauti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kancelaria Osoblja  
02Br. 111-3634/2018  
Klina, 22.05.2018

Opština Klina, na osnovu člana 8 Zakona Rada br. 03/L-212 objavljuje sledeći:

**JAVNI KONKURS**

Za popunjavanje slobodnog radnog mesta

- Lekar Opšte Prakse ( 1 mesto)

Nadzornik: Direktor GCPM

Koeficient – dohodak: 565.51 €

Radno vreme: Puno, po Zakonu Rada

Mesto: Klina-GCPM, CPM, APM

Trajnost imenovanja: Po odredbama Zakona Rada

Broj reference radnog mesta: 07/2018

Cilj i rezultat:

Da organizuje rad u GCPM, CPM, APM

Duznosti i odgovornosti lekara:

- odrzava evidenciju medicinske dokumentacije,
- daje pismene i verbalne upustva za dalji tretman pacijenata,
- vrsi dezurstvo po datom redosledu,
- ucestvuje u pripremi plana i programa rada,
- prepisuje i upravlja date upustva, lekove kao i uptrbljava druge mere ,
- savetuje paciente o zdrastvu i licnoj higijeni,
- izvestava o novim porodajima, smrtima i zbranim bolestima.

Uслови učesća na regrutovanje:

Radno iskustvo:

Stručna sprema: Diploma Medicinskog Fakulteta-opšti smer,odgovarajuća radna licenca i profesionalno iskustvo

Sposobnosti:

- Dobre sposobnosti o organiziranju rada,
- Sposobnost da stvara dobre međuljudske odnose,
- Da ima odlične sposobnosti organizovanja,
- Sposobnost da radi na multietničke ambiente,

Način apliciranja:

Formulari za aplikovanje mogu da se uzimaju u Kancelariju za Osoblje, gde je i objavljen oglas regrutovanja i predaju se u istu Kancelariju, za detaljnije informacije možete da kontaktirate Kancelariju za Osoblje preko tel. 039-471-550 ili mobilni: 044/887659. Oglas ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja. Ne kompletira dokumentacija i ona što stize posle roka ne uzimaju se u obzir.

Civilna Sluzba Kosova pruza ravnopravne mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i dočekuje sve aplikacije ženskog ili muškog pola i svi zajednice Kosova.

Shef Kancelarije Personala  
Xhavit Dauti



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo  
 Qeveria – Vlada – Government  
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
 Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)  
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)  
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinički Centar Kosova –  
 University Clinical Center of Kosovo  
**Sektori i Personelit**



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 6 paragrafi 1.1, nenit 10 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); nenit 13, pika 1, dhe nenit 15, paragrafi 3 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; nenit 5 paragrafi 1 e 2 i rregullores nr. 1003/2016; Kërkesës nr. 1945 datë 21.05.2018; dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpallë:

## K O N K U R S

Nr.	Shërbimi i Infermierisë së QKUK-së	Janë kërkuar	
		Të rregullta	Koeficienti
1.	Infermierë të Përgjithshëm – Bachelor Infer.	20	5.4
2.	Infermierë të Përgjithshëm – Shkolla e mesme	20	4.8
3.	Laborantë – drejtimi mjekësor – Bachelor -Biokimi - Mikrobiologji	2	5.4
4.	Laborantë – drejtimi mjekësor – Sh.mesme për Intstitutin e Patologjisë	3	5.4

